



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .12.2022

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga CNA Media  
Adresa: Selia e Vjetër, Zona Kadastrale 8270  
E-mail : info@cna.al

**TIRANË**

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 2254 datë 09.12.2022 dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të pikës 1.1. të nenit 20 të ligjit nr 45/2015 i ndryshuar dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkohet vënia në dispozicion e informacionit apo të dhënave që disponohen lidhur me figura të spikatura nga sfera të ndryshme të jetës publike konkretisht:

Sh.T.Z.I.M, .....

Sh.T.Z. B.Ç.....,

Sh.T.Znj. L.N.....,

Sh.T.Z.N.P.....

Z. B.F. ....

Z. F.B. ....

Z. A.H..... ju informojmë se :

Së pari : Ligji nr. 45/2015, në nenet 29 dhe 30 të tij përcakton qartë subjektet kërkues që mund të kenë qasje në informacion, në rastin konkret ***institucionet kushtetuese apo autoritetit publike për verifikim zyrtarësh që emërohen apo ngrihen në detyrë, dhe kandidatët për deputet/kryetar bashkie apo subjektet politike në rastin e të zgjedhurve.***

Bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 45/2015, pika 2 “*Institucioni kushtetues dhe autoriteti publik i drejtohet Autoritetit me kërkesë për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij*”.

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, Autoriteti vihet në lëvizje për verifikimin e figurës për çdo kandidat vetëm pas një kërkesë të paraqitur nga institucion kushtetues apo autoritet publik, nga subjektet politike/kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij, **dhe jo kryesisht pra me iniciativë të vetë Autoritetit.**

Vetëm në kushtet kur është paraqitur një kërkesë për verifikim dhe në masën dhe për qëllimet që e lejon ky ligj, lind detyrimi i Autoritetit që “*t’i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyra*” siç përcakton qartë neni 29 i ligjit nr 45/2015 i ndryshuar.

Në zbatim të këtyre dispozitave, pranë Autoritetit, vetëm nga institucioni i Kuvendit të Shqipërisë, në vitin 2017 është paraqitur kërkesë për verifikim figure për shtetasin I.M.. Komunikimi me Kuvendin për këtë çështje është bërë në zbatim të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, duke informuar dhe konfirmuar se shtetasi I.M., disponon certifikatën e pastërtisë së figurës e për këtë arsye nuk mund të verifikohet nga Autoriteti. Ndryshe nga interpretimet që kanë qarkulluar në media mbi informacionin e përcjellë Kuvendit nga institucioni, Autoriteti nuk ka kryer riverifikim të figurës së shtetasit I.M..

Për tre zyrtarët e tjerë të lartë, pranë Autoritetit, nuk është paraqitur asnjëherë kërkesë, qoftë nga institucionet e përcaktuara në ligj për verifikim të figurës së shtetasit qoftë nga vetë zyrtarët.

Sa më sipër, Autoriteti, në mungesë të një kërkesë të paraqitur nga institucionet që u lind detyrimi të kërkojnë verifikimin e zyrtarëve në fjalë apo nga vetë zyrtari në cilësinë e kërkuarit, nuk mund të vihet në lëvizje e rrjedhimisht nuk mund të ketë një vendimarrje të Autoritetit për shtetasit.

Së dyti: sa i takon katër personaliteteve të tjera të fushës së gazetarisë, ligji i posaçëm nr 45/2015, i ndryshuar, nuk i përfshin në rrethin e subjekteve për të cilët të mund të kërkojë verifikimi i pastërtisë së figurës. Sa më sipër, Autoriteti, në mungesë të një kërkesë të paraqitur nga vetë shtetasit në cilësinë e kërkuarit nëse disponohen informacione, të dhëna apo dokumente, për ta në dokumentet e ish- Sigurimit, nuk mund të vihet në lëvizje e rrjedhimisht nuk mund të ketë një vendimarrje të Autoritetit për këta shtetas.

Së treti : Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkuar që mund të kenë qasje në informacion, objektin, qëllimin dhe përdorimin e informacionit, të drejtat e kërkuarve, mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve si dhe kriteret e përdorimit të informacionit.

Kërkesa juaj për informim dhe dokumentacion si media, i nënshtrohet dispozitave procedurale të nenit 38 të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të tij.

Neni 38 **“Informimi i medias”** parashikon të drejtën e përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e Sigurimit si më poshtë:

1. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i dokumenteve nga media kryhet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.
2. Kur publikimi i të dhënave personale, të siguruara sipas këtij ligji, shoqërohet me deklaratë kundërta të personave të përmendur, këto deklaratë u bashkëlidhen të dhënave personale dhe ruhen, vihen në dispozicion e lejohet të publikohen, në të ardhmen, vetëm së bashku me deklaratat kundërshtuese.

Bazuar në dispozitën e mësipërme, nenin 38 të ligjit të posaçëm nr. 45/2015 i ndryshuar, lidhur me të drejtat dhe procedurën për shqyrtimin e dokumenteve, vënie në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve nga cdo media, në faqen zyrtare të Autoritetit mund të konsultohen Udhësuesi për studiues-media si edhe të plotësohet formulari përkatës për aplikim nga studiues-media, të dyja të miratuara nga Autoriteti, me qëllim adresimin e kërkesës tuaj, në dispozitën e përcaktuar nga ligji e më pas vijimin e trajtimit të kërkesës.

Kjo qasje do të garantohet në kushte që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje, e gjithashtu marrjen e miratimit të tyre.

Sic jeni në dijeni kanë hyrë në fuqi tashmë ndryshimet ligjore me ligjin nr 72/2022, të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar.

Detyrat e reja të ngarkuara nga ligjvënësi janë të rëndësishme. Këto detyra shtesë sjellin domosdoshmërisht ndryshimin e akteteve të brendshme lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucionit, udhëzimet, urdhrat etj, me qëllim garantimin e zbatimit korrekt të ligjit nr. 45/2015, dhe informimin me korrektësi të cdo kërkuasi.

Bashkëlidhur gjeni Udhëzuesin për studiues-media dhe formularin për aplikim për studiues-media të miratuara nga Autoriteti.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër  
Drejtori i Informacionit**

**Selami Zalli**